



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:112114
Datë: 09.10.2020
Numri i dokumentit: 01207874

C.nr.577/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Rr. "Lidhja e Pejës", të cilën e përfaqëson me autorizim D.H. kundër të paditurit N.M. nga fshati Komuna Ferizaj të cilin e përfaqëson me autorizim av.Vllaznim Aliaj, në çështjen juridike rimbursim dëmi, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 29.09.2020, mori, kurse me datën 09.10.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve Prishtinë, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri N.M. nga fshati Komuna Ferizaj, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguaj shumën prej 2,160.00€ (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro), me kamat ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vite pa destinim të caktuar nga data 29.09.2020, deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 120€, të gjitha brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Përfaqësuesi e paditëses në fjalën e tij ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë thënie e cekura në seancat e kaluara duke shtuar se nga provat e administruara dhe atë mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit B.L. është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë, kurse përmes marrëveshjes jashtëgjyqësore që ka lidhur paditësja me të dëmtuarin në këtë aksident është vërtetuar lartësia e saj.

Andaj ka theksuar se në këtë çështje kontestimore tia fal besimin mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit B.L., i cili e ka vërtetuar se shkaktuar i këtij aksidenti është ekskluzivisht i padituri e mos t'ia fal besimin ekspertit F.S...

Andaj meqenëse paditësja i a ka kompenzuar dëmin material të dëmtuarit në këtë aksidenti, në procedurë administrative meqenëse i padituri i cili ka qenë duke drejtuar veturën Opel Frontera me targa të regjistrimit, duke drejtuar automjetin nga fshati Jezercë në drejtim të Ferizajt me të ardhur në fshati Neredime e Epërme afër përball market, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes të kushteve të rrugës dhe duke vozitur në mënyrë të pakujdesshme e godet automjetin Golf me targa, i cili ishte i ndalur në skaj të rrugës në anën e djathtë në drejtim të lëvizjes, ku në të cilin aksident por dëmeve materiale lëndime trupore pësojnë edhe pasagjerët, ku vetura të cilin ishte duke drejtuar tani i padituri nuk ka pasur polis siguruese dhe paditësja ka të drejtë që të kërkoj nga i padituri rimbursimin e dëmit respektivisht është detyrim i të paditurit që paditëses t'ia rimbursoj dëmin konform dispozitave ligjore të LSDA-së, duke kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon në tërësi kërkesëpadinë si të bazuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës për ekspertizë dhe për takes gjyqësore për padi.

I padituri përmes të autorizuarit të tij në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet edhe më tutje pranë përgjigjes në padi thënieve të cekura në seancat e kaluara duke shtuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadiës, pasi që e paditura nuk ka arritur të sigurojnë aktgjykimin e plotfuqishëm përmes të cilës dot ë vërtetohej shkaktari i këtij aksidenti, andaj ka theksuar se paditësja është e obliguar të provoj pretendimet e saj në rastin konkretë nuk ka arritur ta bëjë një gjë të tillë, se i padituri është shkaktar i këtij aksidenti.

Njëherit ka shtuar se edhe mendimet edhe konstatimet e ekspertëve të komunikacionit F.S. dhe B.L. nuk kanë arritur ta vërtetojnë saktë veprimet e të paditurit, respektivisht përgjegjësinë e tij, andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që këtyre ekspertizave mos tua fal besimin.

Duke kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar njëherit i ka kërkuar shpenzimet e procedurës

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: U lexua marrëveshja jashtë gjyqësore e lidhur në mes paditëses dhe të dëmtuarit familja R. dt.25.10.2016, raporti i policit hetues 2016-CFT-..... dt.19.03.2016, transferi bankar i datë 15.12.2016 në nr. Rend. 4rezulton pagesa e bërë avokates Labinota Qosa Ilazi, raportet mjekësore lëshuar nga QME

Ferizaj në emër të Sh.R. dt.19.03.2016, raportet mjekësor nga QME për D.R. dt.19.03.2016, raportet tjera mjekësore, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të D.R., dt.30.03.2016 Raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të D.R., dt.16.04.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të D.R., dt.30.03.2016, 19.05.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të Sh.R., dt.23.04.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të D.R., dt.09.04.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të D.R., dt.31.03.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të Sh.R., dt.30.03.2016, raporti mjekësor lëshuar nga QE Ferizaj në emër të L.R.1 dt.19.03.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të L.R.1, dt.31.03.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të L.R.1j, dt.30.03.2016, raporti mejskëor nga poliklinika CT në emër të L.R.1j, dt.09.04.2016, prova tjera mjekësore, autorizimi i paditëses dhenë përfaqësuesit M.P., autorizimi i paditëses dhenë R.K., raporti mjekësor për të dëmtuarën D.R. me nr. 709/16 ncjerr nga ekspertët dr.Xh.S. dhe dr.M.Z., autorizimi i paditëses dhenë përfaqësuesit D.H., autorizimi i të paditurit dhenë av.Vllaznim Aliaj, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit F.S. dt.14.02.2020, autorizimi i paditëses dhenë L.R.2, procesverbal i datës 13.03.2020, në të cilin është dëgjuar eksperti F.S., autorizimi i paditëses dhenë D.H., mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit B.L. dt.22.06.2020.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është pjesërisht e bazuar.

Gjykata nga provat e administruara ka vërtetuar gjendjen faktike se në mes palëve ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e saj.

Gjykata nga provat e administruara dhe atë nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit F.S. e dt.14.02.2020, ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur me kontributin e të dy pjesëmarrësve në komunikacion ku sipas eksperti lëshime primare ka pasur shoferi i veturës A Opel Frontera të cilën ka qenë duke drejtuar tani i padituri, i cili nuk ka qenë i kujdesshëm në komunikacion, nuk ia ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, ndaj kushteve ekzistuese të rrugës, si rezultat i të cilave nuk ka frenuar me kohë, ku edhe pas frenimit e ka goditur veturën B Golf në pjesën e pasme, kurse sipas eksperti ngasësi i veturës B Golf në vendin e aksidentit e ka penguar lëvizjen e lirë të automjeteve, pasi që i njëjti nuk është kujdesur për pozitë e veturës së tij në rrugë.

Kurse gjykata përmes nxjerrjes së provës me ekspertizës të komunikacionit përpiluar nga eksperti B.L.në mendimin e tij të dorëzuar me shkrim të datës 22.06.2020, ku ka konstatuar se

deri te aksidenti ka ardhur me lëshimin e veturës A Opel Frontera të cilën ka qenë duke drejtuar i padituri, sipas ekspertit deri te aksidenti ka ardhur shoferi i veturës A nuk ia ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, nuk e ka mbajtur distancën e nevojshme ndaj automjetit të ndaluar që kishte para vetës dhe vozitësi ka qenë nën ndikimin e alkoolit në shkallë prej 1.66 promil (gjendje e rëndës e dehjes), kurse ka theksuar se edhe pse shoferi i veturës B Golf e kishte ndaluar veturën skaj rrugës së djathtë para market “.....”, në kundërshtim me rregullat e komunikacionit rrugor, mirëpo sipas ekspertit ky veprim nuk është ndërlidhur me shkakun e aksidentit.

Gjykata duke u bazuar në këto ekspertiza, sqarimeve të ekspertëve të cilët janë dëgjuar në seancën e datës 13.03.2020, respektivisht me datën 29.09.2020, ka ardhur në përfundim se deri te aksidenti ka ardhur ekskluzivisht me veprimet e të paditurit, respektivisht shoferi i veturës B nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, ashtu siç e ka përcaktuar eksperti i komunikacionit B.L. për dallim që eksperti F.S. me rasti e dhënies së mendimit të tij dhe sqarimeve të tij nuk e ka specifikuar se i padituri ka qenë nën ndikim të alkoolit, kurse eksperti B.L. e ka konstatua një rrethanë të tillë e cila për gjykatën për veç lëshimeve tjera që ka pasur i padituri rrethana se i njëjti ka qenë edhe nën ndikimin e alkoolit në shkallë prej 1.66 promilë meqenëse është e konstatuar edhe në raportin e policit hetues ka qenë vendimtare për të cilën gjykata ia ka falur besimin mendimit dhe konstatimit të ekspertit B.L., e jo ekspertit F.S. pasi që kjo ekspertizë ka qenë e mangët, për dallim që përshkrimin e aksidentit që të dy e kanë përshkruar në mënyrë të njëjtë pa ndonjë dallim në përmbajtje.

Andaj gjykata konsideron se si rezultat i të cilit aksident vetura që ka qenë duke drejtuar i padituri nuk ka pasur polisë siguroese, ku me veprimet e të cilit ka shkaktuar dëm material dhe jo material të dëmtuarve të cilët përmes marrëveshjes jashtëgjyqësore me numër protokollit 709/16 datës 25.10.2016, e kanë realizuar dëmin tek paditësja në shumë të përgjithshme prej 2,160.00€, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës, të cilën shumë paditësja ia ka transferuar të autorizuarës me datën 15.12.2016, siç vërtetohet përmes urdhër transferit, për të cilin dëm tani paditësja nga i padituri kërkon rimbursimin e tij, pasi që i njëjti në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë duke drejtuar automjetin pa mbulesë siguroese, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses sa i përket lartësisë së saj është e bazuar

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material dhe jo material-regresit ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së dhe në dispozitat e nenit 192 të LMD-së dhe nenit 18 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme, sepse rasti i siguruar nuk ka qenë i siguruar

meqenëse rasti nuk është i mbuluar me polis të sigurimit dhe ka detyruar të paditurin të bëjë regresimin e dëmit në shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata sa i përket lartësisë të kërkesëpadisë gjykata e ka bazuar në marrëveshjen jashtëgjyqësore të lidhur në mes paditëses dhe të dëmtuarve në këtë aksident.

Sa i përket vërejtjeve të paditurit se i padituri nuk ka kontribuar fare në këtë aksident dhe nuk mund të detyrohet të paguaj për një dëm të cilin nuk e ka shkaktuar gjykata konsideron se këto pretendime nuk kanë qenë të bazuara pasi që duke u bazuar në mendimin e dy ekspertëve të komunikacionit është vërtetuar se i padituri ka kontribuar në këtë aksident, por gjykata në rastin konkretë ia ka falur besimin ekspertit B.L., i cili për gjykatën ka qenë më bindës dhe të njëjtit ia ka falur besimin për arsyet e lart cekura dhe mbi këtë gjykata nuk ka gjetur bazë në lidhje me atë që pretendon i padituri se i njëjti nuk ka kontribuar fare në këtë aksident.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërbimit të dëmit material, paditëses ja ka njohur kamatën ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vite pa destinim të caktuara nga data 29.09.2020, deri në pagesën definitive kuptim nenit 378 të LMD-së

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri obligohet që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 120€, dhe atë 100€ në emër të ekspertizës të komunikacionit dhe 20€ në emër të taksës për padi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.577/19, dt.09.10.2020

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.